Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
Nr. 935/26
Data 05.11.26

Prishtinë, 23 tetor 2026
Kodi i ZRRE-së: V_3425_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Mbështetur në Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084); Nenin 19 paragrafin 2 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, Vendimi për Lëshimin e Autorizimit V_2639_2025 të datës 27 janar 2025 për shoqërinë "Anik Energy" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW ZK Grackë e Vjetër, komuna e Lipjanit dhe kërkesën për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit për Autorizim V_2639_2025 edhe për 6 (gjashtë) muaj, për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW ZK Grackë e Vjetër, komuna e Lipjanit, të datës 20.07.2026 nr. prot. 591/26 të shoqërisë "Anik Energy" SH.P.K., me adresë: Rr. "Ibrahim Rugova", pn Lipjan, Republika e Kosovës; dhe

në seancën e mbajtur më 23 tetor 2026 nxori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET** – kërkesa e shoqërisë "Anik Energy" SH.P.K., dhe **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së autorizimit V_2639_2025 të datës 27 janar 2025 për vazhdimin e ndërtimit e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW ZK Grackë e Vjetër, komuna e Lipjanit.

II. **OBLIGOHET** - shoqëria "Anik Energy" SH.P.K., që brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të këtij Vendimi për vazhdim të afatit të vlefshmërisë së Vendimit V_2639_2025, që të dorëzoj garancionin financiar në vlerë prej 7% të vlerës së projektit, të lëshuar nga një Bankë Komerciale e licencuar apo kompani e sigurimeve në Republikën e Kosovës, me vlefshmëri që mbulon periudhën sipas Planin Dinamik të Realizimit të Aplikuesit.

III. Garancioni financiar sipas pikës II. të këtij Vendimi, do të jetë në vlerën prej 180,757.50€ (njëqind e tetëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë euro e pesëdhjetë cent), sipas vlerës së projektit të prezantuar me Planin e Biznesit me rastin e aplikimit për Autorizim dhe duhet të mbulon periudhën deri **31.01.2028**.

IV. Kushtet tjera të vendosura me Vendimin V_2639_2025 mbesin të pa ndryshuara dhe duhet të zbatohen nga aplikuesi.

Arsyetim

- ZRRE, me datë 20.07.2026, nga "Anik Energy" SH.P.K., ka pranuar kërkesën për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit V_2639_2025 të datës 27 janar 2025, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW.

- Në kërkesën e saj, aplikuesi ka arsyetuar se gjatë realizimit të projektit është përballur me rrethana objektive dhe të paparashikuara, të cilat kanë ndikuar në dinamikën e realizimit të projektit. Sipas aplikuesit, gjatë periudhës së implementimit ka pasur rritje të konsiderueshme të çmimeve në tregun ndërkombëtar të pajisjeve dhe materialeve elektroenergjetike, si dhe ndryshime në strukturën e pronësisë së shoqërisë, të cilat kanë kërkuar kohë shtesë për përfundimin e procedurave administrative dhe organizative, pa ndikuar në përkushtimin për realizimin e projektit.

- Aplikuesi ka njoftuar gjithashtu se punimet në terren kanë vazhduar me intensitet, se pjesa dërrmuese e punimeve është realizuar, si dhe është përfunduar dhe aprovuar projekti nga KEDS për pjesën e linjës së kyçjes dhe lidhjes së projektit me rrjetin elektroenergjetik. Po ashtu, sipas kërkesës, vonesa në përfundimin e projektit lidhet edhe me afatet e zgjatura të furnizimit me transformatorë energjetikë, të cilat konsiderohen rrethana jashtë kontrollit të investitorit.

- Si mbështetje të kërkesës, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin përkatës, përfshirë dëshminë për pagesën e pajisjeve, fotografi nga vendpunishtja që paraqesin progresin e punimeve, si dhe dokumentacion tjetër mbështetës për realizimin e projektit.

- Kërkesa për shtyrjen e afatit është bazuar në dispozitat e Rregullës Nr. 03/2022, sipas së cilës aplikuesi mund të kërkojë vazhdimin e afatit të realizimit të projektit, kur vonesat janë të arsyetuara dhe kanë qenë jashtë kontrollit të tij. Po ashtu, edhe Vendimi për Autorizim i njeh aplikuesit të drejtën që të kërkojë shtyrjen e afatit në përputhje me kushtet e përcaktuara në Rregullën e Autorizimit.

- Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit mbështetës të dorëzuar nga aplikuesi, konstatohet se kërkesa është paraqitur në pajtim me dispozitat e Rregullës Nr. 03/2022, ndërsa aplikuesi ka paraqitur dokumente dhe prova që synojnë të argumentojnë arsyet e shtyrjes së afatit dhe progresin e realizimit të projektit.

- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të kërkesës për shtyrje të afatit të Autorizimit, dëshmive të bashkangjitura, ka ardhur në përfundim se në aspektin administrativ dhe arsyeve faktike të prezantuara nga dëshmitë përkatëse duke pasur parasysh edhe vonesat kanë ardhur si rezultat i pengesave administrative, të cilat vonesa vlerësohen se janë jashtë kontrollit të aplikuesit, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Driton Gojani, Kryesues

Arta Isufi, Anëtare

Adhan Preniqi, Anëtar

Lutfije Dervishi, Anëtare

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Lipjanit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.